



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVEINDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Përcaktimesh-Kancelaria e Propozimeve-Tablica Odloz
No. Prop. 05/2607/10-1309
No. Prop. 10.10.2016
Data: 10.10.2016
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

PËR/ZA/TO	<i>Ministrin e Punëve të Brendshme z. Skender Hyseni</i>	DATE DATUM DATE	11.10.2016.
NGA/OD/FROM	<i>Deputetja Ganimete Musliu</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	<i>Pyetje për përgjigje me gojë</i>		

Në bazë të nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

I nderuar Ministër

Policija e Kosovës e ka të drejtën dhe strukturën e njësisë ajrore- për helikopter.

PYETJE :

I nderuari Ministër:

Duke marrë parasysh që mund të kemi raste ku intervenmi policor me automjete është i pamundur, kur do të merr Qeveria vendim për paisjen e policisë me helikopter?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Përcaktimesh - Kancelarija za Predložnje i Pristavke - Table Office

No. Prop. Br. Prop. Prop. No. 05/2602/0-1310

Data Datum Data 10.10.2016

PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

PËR / ZA / TO	<i>Ministrin e Punëve të Brendshme z. Skender Hyseni</i>	DATE DATUM DATE	11.10.2016.
NGA / OD / FROM	<i>Deputetja Ganimete Musliu</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	<i>Pyetje për përgjigje me gojë</i>		

Në bazë të nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

I nderuar Ministër

Duke marrë parasysh aktivitetin e Policisë së Kosovës dhe rrezikshmërinë e tyre në punë.


PYETJE :


I nderuari Ministër:

Kur do të kenë sigurim shëndetësor Policia e Kosovës?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly



PËR / ZA / TO	<i>Skender Hyseni</i> <i>Ministër i Punëve të Brendëshme</i>	DATE DATUM DATE	11.10.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Zafir Berisha Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës 		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Grupi Parlamentar NISMA për Kosovën		

Në bazë të Rregullës 45.2 të Rregullorës së Punës së Kuvendit të Kosovës bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës

Çështja: Financimi i dyshimët i OJQ-ve në pjesën veriore të Kosovës.

Me datën 5 tetor 2016 gjatë raportimit në Komisionin për Politikë të Jashtme të ministrit Enver Hoxhaj, mes tjerash ka thënë se në pjesën veriore të vendit veprojnë 3 deri në 4 OJQ të cilat financohen nga shteti Rusë .

Pyetja: Cilat janë ato OJQ, A jeni në dijeni për misionin e tyre dhe a veprojnë në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës?



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Përcaktim - Kancelarija e Pradhoje i Prudstevke-Table Office
Nr. Prot. 05/2613/00-1317
Data
Date:
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR/ZA/TO	z. Skënder Hyseni Ministër i Punëve të Brendshme	DATE DATUM DATE	13.10.2016
		Reference	
NGA/OD/FROM	Aida Dërguti Deputete e Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje Parlamentare për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.


ÇËSHTJA: Nga mbledhja e parë e përbashkët midis Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë, në 11 janar 2014 dhe marrëveshjeve të dakorduara, qeveria në Tiranë mori vendim me datë 7 maj 2014 për *Përfundimin nga detyrimi për pajisje me leje pune dhe certifikatë regjistrimi në punë për shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e Republikës së Serbisë të përkatësisë etnike shqiptare.*

Në mars 2015, pra 1 vit më vonë Ministria Punës dhe Mirëqenies Sociale njoftonte se u firmosën tri marrëveshje bashkëpunimi me Republikën e Shqipërisë. Nënshkrimi u bë në atë kohë nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Erion Veliaj dhe homologu i tij Arban Abrashi. “Më konkretisht u arrit marrëveshja për heqjen e lejeve të punës dhe liberalizimin e tregut të punës mes dy vendeve, nga Gjirokastra deri në Mitrovicë”.

Shqipëria i ka hequr lejet e punës për shtetasit nga Kosova, ndërsa Kosova u zotua ta bëjë këtë shumë shpejt për shtetasit e Republikës së Shqipërisë. Në pyetjen e shtruar Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, në seancën e kaluar ai u përgjigj se për këtë duhet të pyesim Ministrin e Punëve të Brendshme dhe se Ministria që drejton ka lobuar për këtë ndryshim si dhe e ka kryer punën por Ministria e Punëve të Brendshme ende nuk e ka realizuar pjesën e saj.

Tani jemi 2 vite e 5 muaj nga mbledhja e dy qeverive dhe 1 vit e gjysmë nga nënshkrimi i marrëveshjes për lejet e punës.

PYETJA PARLAMENTARE: Z. Ministër pse nuk po e zbatoni marrëveshjen e nënshkruar nga Kryeministri dhe Ministrat e Republikës së Shqipërisë me homologët e tyre në Qeverinë e Kosovës, duke mos i hequr ende lejet e punës për shtetasit e Shqipërisë dhe shqiptarët që jetojnë në shtete të tjera të rajonit ?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	Z. Isa Mustafa Kryeministër i Qeverisë së Kosovës	DATE DATUM DATE	13.10.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Donika Kadaj Bujupi Deputete e Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje Parlamentare për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA: Z. Kryeministër, në mbledhjen e Komisionit parlamentar për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e cila u mbajt me 10 tetor 2016, Ministria për dialog në Qeverinë e Republikës së Kosovës znj. Edita Tahiri tha se Qeveria e Kosovës nuk i ka listat e personave të pagjetur, të rrëmbyer në luftën e fundit, dhe se kjo është arsyeja sipas saj, që kjo çështje ka mbetur pa iu shtruar Serbisë.

PYETJA PARLAMENTARE: z. Kryeministër a mund të na e tregoni listën zyrtare të Republikës së Kosovës me të dhënat e personave të pagjetur dhe numrin e tyre?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
SKUPŠTINA REPUBLIKËS SË KOSOVËS
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Propozime të Radhësuar / Pristinska Tabela Office

Nr. Prop. 05/2623/00-1329
M. Prop. 17-10-2016
Pr. No. 17-10-2016
Date 17-10-2016
PRISTINE - PRISTINA - PRISTINA

PËR / ZA / TO	Z. Isa Mustafa Kryeministër i Qeverisë së Kosovës	DATE DATUM DATE	17.10.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Ismajl Kurteshi Deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE!		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA: Këshilltari komunal pjesëtar i strukturave paralele.

Z. Kryeministër, Këshilltari komunal, në Kuvendin Komunal të Gjilanit, z. Srdjan Mitrovic, me 11 dhjetor 2015 është emëruar nga Kryeministri i Serbisë Aleksandar Vuçiq, kryetar i i organit të përkohshëm të Komunës së Gjilanit.

Neni 3, paragrafi 2 i Ligjit për Zgjedhje lokale, ju ndalon anëtarëve të kuvendeve komunale të jenë anëtar të ndonjë organi të zgjedhur.

Në bazë të kësaj dispozite ligjore Kuvendi Komunal, me 29 shkurt 2016 e ka përjashtuar z. Mitrovic nga seanca me arsyetimin se i njëjti është emëruar kryetar komune, si strukturë paralele nga Qeveria e Serbisë .

Ministria e Pushtetit Lokal në shkresën e 16 marsit 2016, në lidhje me këtë rast përveç tjerash shkruan "... lidhur me marrjen e veprimeve për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Mitrovic tejkalon autorizimet e Kuvendit të Komunës..." .

Kuvendi Komunal i Gjilanit përsëri e ka përjashtuar z. Mitrovic nga seanca e mbajtur me 29 shtator 2016 dhe ka kërkuar nga i njëjti që të sjell dëshmi se ka dhënë dorëheqje nga strukturat paralele serbe të instaluar në Kosovë.

Z. Mitrovic ka deklaruar po atë ditë se nuk e ka ndërmend të jep dorëheqje.

PYETJE PARLAMENTARE: Z. Kryeministër pse Qeveria po hesht dhe nuk po ndërmerr asgjë për pengimin e kësaj dukurie antiligjore?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKËS KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Përzihje të Konkludimeve të Traçkëve / Prastovke-Table Office

Nr. Prot. 05/2624/10-1325
B. Prot.
Prot. No.

Nr. i faqeve 17-10-2016
Broj stranica
No. pages
Date Datum
Date

PRISHTINE - PRISTINA - PRISHTINA

PËR / ZA / TO	Z. Skënder Hyseni Ministër i Punëve të Brendshme	DATE DATUM DATE	17.10.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Ismajl Kurteshi <i>Ismajl Kurteshi</i> Deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE!		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA: Shqiptarët e Luginës së Preshevës pa Status

Z. Ministër, dhjeta - mija shqiptarë të Luginës së Preshevës, të dëbuar nga Pushteti i Serbisë në vitin 2001, jetojnë në Kosovë pa status të rregulluar.


Të njëjtit janë hequr nga evidenca e institucioneve të Serbisë dhe atje nuk mund të nxjerrin dokumente të identifikimit dhe udhëtimit. Kurse kusht i MPB –të Kosovës, për dhënien e lejes për qëndrim të përkohshëm është pikërisht letërnjoftimi i Serbisë. Për kthimin e të dëbuarve në shtypit e tyre duhet përkrahja e institucioneve të Kosovës, Shqipërisë dhe ndërkombëtare.


Në përgjigjen e MPB-së drejtuar Zyrës për Preshevë, Bujanocë dhe Medvegje, në gusht të këti viti, në lidhje me lejen e qëndrimit, përveç tjerash thuhet: “ ... është parapa një nenë për shtetasit e huaj ku kanë të drejt të aplikojnë për leje qëndrim të përkohshëm për qëllime tjera ku e kemi parapa që në këtë kategori të hynë edhe shqiptarët nga Lugina e Preshevës të cilët dëshmojnë se jetojnë në Kosovë nga viti 1999”.

PYETJE PARLAMENTARE: Z. Ministër, shqiptarët e Luginës kanë shumë probleme me administratën e MPB që i pengon ata t'i realizojnë të drejtat më elementare të njeriut si që është e drejta në shkollim, në shërbime shëndetësore, sociale etj. si dhe kur do ta zgjidhni këtë problem të këtyre qytetarëve?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly



PËR / ZA / TO	<i>Imet Rrahmani</i> <i>Ministër i Shëndetësisë</i>	DATE DATUM DATE	17.10.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Shukrije Bytyqi Deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës 		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Grupi Parlamentar i NISMA për Kosovën		


Në bazë të Rregullës 45.2 të Rregullorës së Punës së Kuvendit të Kosovës bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës

Çështja: Që shëndetësia po degradohet çdo ditë e më shumë u dëshmuar edhe nga konkursi i fundit i Ministrisë së Shëndetësisë për pranimin e kandidatëve për specializant të rinjë. Ky konkurs u percjellë me shumë parregullësi e nepotizëm gjatë intervistave pyetjet janë përsërit dhe nuk kanë qenë adekuate, kandidatët janë vlerësuar edhe nga antarët e komisionit që nuk kanë qenë prezent fare në komision, nuk janë numëruar poenat për kandidatet familjar të dëshmorit, në gjuhë angleze janë vlerësuar nga personat që vetë nuk e dinë gjuhën angleze e shumë parregullësi tjera. E këto parregullësi e sollën një listë me kandidatë familjar e miq të mjekeve të QKUK-së, antarëve të komisionit dhe njerëzve tjerë të politikës.

Pyetja: z. Ministër si është e mundur që nota mesatare 10.0 dhe koha e pritjes nga data e licencimit 3 vite të vleresohen 21.73 % kurse paraqitja para kimisionit (e bërë me një pyetje) të bëjë 78.27 % te vleresimit?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly



PËR / ZA / TO	<i>Imet Rrahmani</i> <i>Ministër i Shëndetësisë</i>	DATE DATUM DATE	17.10.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Shukrije Bytyqi Deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Grupi Parlamentar i NISMA për Kosovën		

Në bazë të Rregullës 45.2 të Rregullorës së Punës së Kuvendit të Kosovës bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës

Çështja: Me date 02.07.2015 e kam ngritë çështjen e moslicencimit te rreth 100 studentëve të diplomuar në FSHMN departamenti i biologjis drejtimi biokimiko-fiziologjik dhe aplikativ (bachelor) të cilët kanë mbetur pa licenca dhe pa asnjë të drejtë të punës. Këtë drejtim e ka akredituar MASHT-i dhe organet vartëse (agjensioni për akreditim). Ju kam drejtuar kryeministrit pasi që për të diplomuarit në drejtimin e lartpermendur ish kryeministri ka leshuar vendim me datë 07.05.2009 që tu jepen licencat.

Ministria e Shëndetësisë ka licencuar të diplomuar me të njejtin drejtim në kolegje private dhe në universitete rajonale.

Pyetja: Ministër, në bazë të cilave kritere ju i keni licencuar te diplomuarit në kolegje private?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKES SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Fierdhje - Kancelarija za Predložke i Pristavke-Table Office

Nr. Prot. 05/2630/10-1331
Bi. Prot.
Prot. N.
Data Datum Date 17.10.2016
No. pages
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

PËR / ZA / TO	Z. Imet Rrahmani Ministër i Shëndetësisë	DATE DATUM DATE	17.10.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Besa Baftiu, deputete e GP Lëvizja VETËVENDOSJE! 		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA

Z. Ministër, ditë më parë MSh publikoi listat e mjekëve që kanë fituar të drejtën e specializimit. Siç e dini edhe ju ka shumë ankesa nga ana e atyre që nuk kanë përfituar specializimet. Ky grup i mjekëve pretendon se ka pasur shumë parregullsi në këtë përzgjedhjen e kandidatëve. Këto brenga këta i kanë shprehur edhe duke protestuar para ministrisë, mirëpo ata nuk kanë pasë mundësi të takohen me asnjë zyrtar nga ana e Minsitrisë dhe në mungesë të përgjigjejes ata ju kanë drejtuar antarëve te komisionit parlamentar ku në detaje kanë dhënë argumente të mjaftueshme se ky proces në tërësi është i paraporositur dhe i gatuar me direktiva politike dhe plotësisht nepotike.

PYETJE: Ju si Ministër çka keni ndërmarrë në këtë drejtim që të zbardhet e vërteta sa i përket këtyre manipulimeve që janë bërë në këtë konkurs?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKES SE KOSOVES
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Kërkesat: Kancelaria e Propozimeve dhe Propozimeve
No. Prot. 05/2632/10-1333
Bi. Prot. 17.10.2016
Pr. Prot. 17.10.2016
No. pages. 1
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

PËR / ZA / TO	Z. Imet Rrahmani Ministër i Shëndetësisë	DATE DATUM DATE	17.10.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Besa Baftiu, deputete e GP Lëvizja VETËVENDOSJE!		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA

Nga stopimi i lëshuarjes së certifikatave mjekësore nëpër QKMF, sipas statistikave të hyrat e QKMF-ve nëpër Kosovë kanë rënë me 3-4fish, pasi që tani këto certifikata lëshohen ekskluzivisht nëpër institucionet private shëndetësore. Edhe pse jemi pro konceptit të mjekësisë familjare, do të duhej të gjendej një zgjidhje që specialistët e nevojshëm për lëshimin e këtyre certifikatave të jenë prezent vetëm në QKMF, në mënyrë që mjetet të inkasohen në institucionet publike, mjete të cilat do të zhvillojnë akoma me shume shëndetësinë publike dhe shërbimet ndaj qytetarëve. Kjo zgjidhje do të mund të bëhet ose përmes lejimit të punësimit të këtyre specialistëve (vetëm në QKMF), ose përmes një vendimi apo UA nga MSH, ku do të lidhej një marrëveshje bashkëpunimi me institucionet dytësore dhe tretësore publike, në mënyrë që certifikatat të lëshohen nga Institucionet publike shëndetësore të cilat do të jenë më të besueshme (pasi lëshohen nga institucionet publike) por do të shërbenin edhe si mekanizëm i rritjes së inkasimit të mjeteve të domosdoshme për shërbime cilësore në Institucionet publike shëndetësore.

PYETJE

A do të ndërmerri diç në këtë drejtim në mënyrë që certifikatat mjekësore për patent shofer të lëshohen edhe nga institucionet publike shëndetësore.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIC OF KOSOVO
KOSOVË
ASSEMBLY OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Përfundim të Punëve të Pritura / Table Office
05/2640/Do-1340
18-10-2016
PRISTINA - PRISTINA

PËR / ZA / TO	Z. Arban Abrashi Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale	DATE DATUM DATE	18.10.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Visar Ymeri Deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE!		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja

Sipas raportit të fundit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm "Siguria në punë i punonjësve në sektorin e ndërtimtarisë" është rritur numri i aksidenteve të rënda të punëtorët që janë të punësuar në sektorin e ndërtimtarisë. Inspektimi dhe monitorimi i zbatimit të legjislacionit që mbulon këtë sektor është në kuadër të Ministrisë që ju e udhëheqni.

Pyetja Parlamentare

Z. Ministër, a mund të na tregoni për numrin e saktë të këtyre aksidenteve dhe çka keni ndërmarrë në lidhje me këtë çështje?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKES SE KOSOVES
SKUPSTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Parashitje - Kancelarija za Predloge i Prishtevke - Table Office

№ Prot. Br. Prot. Prot. No: 05/2641/D₀-1341
Data Datum Data: 18.10.2016
No. pages: PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA

PËR / ZA / TO	Z. Isa Mustafa Kryeministër i Qeverisë së Kosovës	DATE DATUM DATE	18.10.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Salih Salihu Deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE!		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja

1. Z. Kryeministër, është raportuar ditë më parë se ju, Kryetari i Pejës Gazmend Muhaxheri dhe përfaqësues të kompanisë austriake "Kelkos Energy" keni zhvilluar një takim të fshehtë larg opinionit. Siç besohet në takim keni diskutuar për projektin e kompanisë austriake për ndërtimin e pesë njësive gjeneruese për prodhimin e rreth 60 megavat energji elektrike në Lumbardhë.

Pyetja

Pyetja ime Kryeministër është, a mund të tregoni më hollësisht rreth zhvillimit të këtij takimi dhe a konsideroni se me këtë takim jeni duke favorizuar një kompani private që bie ndesh me konkurrencën e lirë dhe njëkohësisht jeni duke anashkaluar gjithë opinionin publik, qytetarët dhe organizatat joqeveritare?



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKES SË KOSOVËS
SKUPSTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Propozitura-Kancelaria për Pradime dhe Propozime-Table Office

Nr. Prop. /
Nr. Prop. /
Prot. No. /

05/2652/10-1348

Nr. i faqeve /
Broj. stranica /
No. pages: /

Data /
Datum /
Date: 20-10-2016

PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

PËR / ZA / TO	z. Lutfi Zharku Ministër i Ministrisë së Infrastrukturës	DATE DATUM DATE	20/10/2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Abdyl Ymeri, Deputet		
SUBEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA:

Monopoli, është e drejta që ka vetëm dikush për të prodhuar diçka, për të tregtuar një mall ose për të përdorur a shfrytëzuar diçka. Një rast të tillë e kemi në homologimin e veturave që regjistrohen për herë të parë në Kosovë. Në vitin 2009 në mes të MTPT-se dhe kompanisë “EuroLab”, është nënshkruar kontrata dhe dhënia e autorizimit për homologim, pa përfillur dhe pa shpallur procedura të tenderimit, e në të njëjten kohë, duke shmangur në këtë formë edhe konkurrencën, duke i dhënë qasje ekskluzive vetëm një kompanie.

Në një analizë dhe hulumtim të institutit GAP, shihet qartë se kemi një varg shkeljesh ligjore dhe këtu kemi monopol të pastër, që në formën tjetër i dëmton qytetarët se nuk kanë zgjidhje tjetër, e po ashtu nuk kemi liberalizim të tregut në këtë segment.

Me 12 gusht 2015, Qeveria në pajtim me nenin 119, paragrafi 3 i Kushtetutës dhe dispozitave të Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës aprovoi vendimin nr. 17/44 me të cilin fillohen procedurat për eliminimin e të gjitha veprimeve që kufizojnë konkurrencën e lirë, përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, si dhe ato të cilat krijojnë detyrime për qytetarët, të cilat nuk janë paraparë me ligjet në fuqi.

PYETJE PARLAMENTARE:

z. Ministër, një vendim i tillë ju obligon edhe ju dhe ministrinë të cilën e drejtoni, me intereson të dijë së cilët hapa i keni marr ju për të eliminuar dukurinë e monopolit në fushën homologimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Parashtrëse-Kancelarija za Predložke i Predstavka-Table Office

Nr. Prot. No. 05/2670/10-1367
Br. Prot. No.
Pr. No.

Nr. i faqeve
Broj strana
No. pages:

Data
Datum
Date: 25.10.2016

PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	Znj. Dhurata Hoxha Ministre e Drejtësisë	DATE DATUM DATE	25.10.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Albulena Haxhiu Deputete e Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me shkrim		

Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, parashtroj pyetje për përgjigje me shkrim:

ÇËSHTJA

Sipas disa informacione nga Qendra Korrektuese e Prizrenit, të burgosurve u janë shkurtuar të drejtat. Fjala është për cilësinë e ushqimit por poashtu na kanë njoftuar edhe për keqtrajttime psikike dhe fizike. Në veçanti, të keqtrajtuar, janë grupi i komunitetit rom.

PYETJA PARLAMENTARE

E nderuara znj. Ministre Hoxha, raste të ngjashme mund të ketë edhe në qendrat tjera korrektuese. A jeni në dijeni për këto shkelje dhe keqtrajttime?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly


REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI / SKUPŠTINA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO / SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
Zyra për Propozime dhe Përshirasa / Kancelarija të Propozimeve i Prishtinës / Table Office
No. Prot. / Nr. Prot. / Prot. No. 05/2671/10-1362
Date / Datum / Data 25. 10. 2016
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA

PËR / ZA / TO	Z. Isa Mustafa, Kryeministër i Republikës së Kosovës.	DATE / DATUM / DATE	25, Tetor 2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Rrustem Berisha, deputet, Grupi Parlamentar i AAK-së <i>Berisha</i>		
SUBJEKTI / PREDMET / SUBJECT	Pyetje për përgjegjje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45.2 të Rregullorës së Punës së Kuvendit të Kosovës bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës

Qështja: Komisionit Qeveritar për verifikimin e statusit të veteranëve, invalidëve dhe dëshmorëve të luftës, i ka skaduar mandati me datë 20 maj 2016, sekretaria ishte pjesë e këtij komisioni, që nga ajo datë puna e sekretarisë është pezulluar edhe pse kanë mbetur edhe shumë punë të papërfunduara, kjo sekretari duhet ti qertifikoj edhe listat përfundimtare të invalidëve dhe të dëshmorëve, vazhdimësi e kësaj është edhe formimi i Komisionit mjeksorë për përcaktimin e shkallës së invaliditeti.

Pyetja: Kur do të fillon punën sekretaria e veteranëve?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	Imet Rrahmani Ministër i Shëndetësisë	DATE DATUM DATE	25.10.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Aida Dërguti Deputete e Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me shkrim		

Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, parashtroj pyetje për përgjigje me shkrim:

ÇËSHTJA

Në konkursin e fundit të specializimeve që është ndarë nga Ministria e Shëndetësisë për profile të ndryshme nuk është ndarë asnjë specializim për spitalin e Vushtrisë duke e ditur se ky spital ka mungesë të mjekëve specialistë të lëmive të ndryshme

PYETJA PARLAMENTARE

Z. Ministër, a mund të na tregoni pse nuk është ndarë asnjë specializim për spitalin e Vushtrisë?